



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2018:015863

Datë: 29.03.2019

Numri i dokumentit: 00261606

P.nr.156/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Nexhat Aliu, me Sek. Juridike, Lumturije Fetahu, në qështjen penale të akuzuarit **B.SH.** nga fsh. ..., K.Viti, i akuzuar për shkak të veprës penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 parag.1, të KPRK-së, e sipas aktakuzës PP.II.nr.675/2018, të dates 11.05.2018, dhe pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, dhe publik me 27.02.2019 shpall këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.SH nga babai ..., dhe nëna ..., i vajzeris ..., i lindur ... në Gjilan, ndersa jeton ne fsh.... K.Viti, me numer personal ..., ka te kryer shkollen e mesme, pune, sezonal, me gjendje të varfur ekonomike, i pa martuar, deri më tani kinse i pa denuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTORË
SEPSE**

Me datën 01.05.2018 rreth ores 21:00 minuta ne fshatin ... Komuna e Vitise Policor e Stacionit Policor në Pozheran, ka ndaluar nje veture te markes "Golf IV" me targa ..., dhe gjate kontrollit fizik te i pandehuri B.SH. si pasagjer mbrapa ne veture eshte gjetur nje kavanoz prej qelqi, me substance narkotike e llojit "Marihuane" e cila ka peshuar 15.8 gram, e te cilen kinse e kishte blerë nga nje person i panjihur nga Prishtina, ne vlerë prej 10(dhjetë euro). E per ta perdor per nevoja personale, per festen e majit, me q'raste substance narkotike eshte sekuestruar, dhe ne kete menyre i pandehuri me veprimet e veta pa leje dhe autorizim ka poseduar substance të rrezikshme narkotike.

-me cka ka kryer veper penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve,substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 parg. 1, KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenëve 41,42, 50,51,46 dhe neni 73 të KPRK-së, dhe neni 365 të KPPRK-së.

E G J Y K O N

Me denim burgu në kohzgjatje prej **1 (një vitë)**, i cili dënim nuk do të egzekutohet, **ME KUSHT** që në afat prej **18 muajsh** mos të kryej vepër tjetër penale, dhe

Me denim gjobë në shumë prej **300.00 Eu, (treqind euro)**.

Denimin e shqiptuar me gjobë do ta paguajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast të mosë pagesës i njeiti do të shendrohet në denim burgu efektiv prej **25 ditësh**, duke llogaritu nga **20.00 euro (njizeteuro)**, për një ditë burgu.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej **20,00 € (njizeteuro)**, kurse në emër të paushallit gjyqsor shumën prej **10,00 € (dhjeteuro)**.

- E në bazë të nenit 275 parg. 3, të KPRK-së, substancat narkotike e llojit Marihuanë, në sasi prej 15.8, gram, e sekuestruar të Konfiskohet.

Obligohet i akuzuari të paguaj taksen në shum prej 30 Euro, për kompensimin e viktimave të krimit në bazë të nenit 39 parag. 3 nënparag. 3.1 të LPKVK-it.

A r s y e t i m

PSH-re, nga Gjilani, me dt.11.05.2018, ka ngritur aktakuzen PP.II.nr.675/2018 kundër të akuzuarit B.SH nga fsh. ..., K.Viti, për shkak të veprës penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve,substancave psikortope ose analoge nga neni 275 paragrafi 1, të KPRK-së.

I akuzuari B.SH ka pranuar fajsin për veprën penale e cila i vihet në barrë si në aktin akuzues. Edhe pse ka qenë i njoftuar me pasojat dhe favoret e pranimit të fajsisë.

PSH-re, nga Gjilani, Huma Jetishi në fjalën përfundimtare të palve ka deklaruar: mbesë prane aktakuzes se lexuar dhe propozimeve e cila i përmban pasi që gjendja faktike u vërtetuar edhe me pranimin e fajsis nga i akuzuari në këtë shqyrtim, pranimi ky i cili është me perputhshmeri me provat të tjera, te cilat janë propozuar për tu shtjelluar për ta vërtetuar drejte gjendjen faktike, me rastin e matjese dhe shqiptimit të denimit të mirren parasysht te gjitha rrethanat e posaqerishte rrethana lehtesuese te mirret parasysht se i njeiti e ka pranuar fajsin, ishte korrekt para gjykatës, dhe i premtoj gjykates se ne te ardhmen nuk do te kryejn veper tjeter penale, si rrethan renduese shkalla e pergjegjesis dhe rrezikshmerise shoqërore .Njeherit i propozoj gjykates qe subpstranca narkotike e llojit marihuan ne sasi prej 15.8G te konfiskohet,

I akuzuari B.SH në fjalën përfundimtar të palve ka kërkuar nga gjykata që të shqipton një dënim më të butë, është penduar për kryerjen e kësaj veprë penale i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjetër penale të këtij lloji apo të llojit tjetër.

Gjykata analizoi mbrojtjen e të akzuarit, provat e administruara dhe erdhi në përfundim se i akuzuari B.SH nga fsh..., ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 1. të KPRK-së, që u vërtetua nga pranimi i fajsisë nga ana e vet të akzuarit për këtë veprë penale.

Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata ka pasë parasysh sjelljen korrekte në gjykatë, ka pranuar fajsinë pa asnjë hezitim qysh në shqyrtimin fillestar, është penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë penale, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të këtij lloji apo llojit tjetër, me gjendje të varfer ekonomike dhe financiare pa kurrfarë të ardhura personale.

Ndërsa si rrethana rëndues shkallen e përgjegjësisë penale, rrezikshmerin shoqërore, nga se këto vepra kanë marrë permasa shqetsuse në komunën tonë.

Gjykata ka aprovuar kërkesën e prokurorisë, në bazë të nenit 275 paragrafi 3, të KPRK-së, substancat narkotike e llojit Marihuanë, në sasi prej 15.8, gram, e sekuestruar të Konfiskohet.

Për këtë arsye i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se edhe ky dënim kumulativ do të ndikoi pozitivisht tek i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 450, të KPRK-së. Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**

**P.nr.156/2018
2018:015863, 27.02.2019**

Sekretare Juridike,
Lumturije Fetahu

Gjyqtari,
Nexhat Aliu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mundë të ushtrohet ankesë në afatë prej 15 ditësh, nga dita e pranim, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.